



Republika e Kosovës
Republika Kosovo- Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni Pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 16

Prishtinë, më 20.02.2018, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Korab Sejdiu, Nezir Çoçaj, Igor Simiq, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Mungoi: Glauk Konjufca.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Besjana Bajrami, Ekonomia Online; Ismail Shabani, Arbër Hajdari dhe Jasir Zeqiri, KosovaPress; Burim Tahiri, IAP; Ardit Kika, BIRN; Rreze Hoxha, GLPS; Gzim Shala, IKD/BPD; Nehat Dervishi, OSBE; Agnesa Haxhiu, KDI; Shefki Kastrati, NDI dhe Altina Besimi, Ambasada e Britanisë së Madhe.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i draft- Rregullores së Kuvendit i propozuar nga grupi punues;
3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale.
4. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me kandidatët për anëtar të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës;
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-030 për Aktet Juridike;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime, duke u hequr pika 5 nga rendi i ditës.

2. Shqyrtimi i draft-Rregullores së Kuvendit i propozuar nga grupi punues

Albulena Haxhiu, kryetare, paraqiti për shqyrtim draft- rregulloren e Kuvendit i propozuar nga grupi punues dhe e ftoi të marrë fjalën z. Hajdar Beqa në cilësinë e kryesuesit të grupit punues.

Hajdar Beqa tha se grupi punues për hartimin e Rregullores së Kuvendit, duke vepruar në pajtim me vendimin e Komisionit për Legjislacion, të datës 17.10.2017, në përbërje Hajdar Beqa, kryesues, Korab Sejdiu, Albulena Haxhiu, Shkumbin Demaliaj, Bilall Sherifi, Bahrim Shabani dhe Igor Simiq, anëtarë, kanë mbajtur disa takime lidhur me Projekt-Rregulloren e Kuvendit. Pa dyshim që është një version i avancuar i rregullores

Grupi punues, duke analizuar qëllimin e Projekt-rregullores, përmbajtjen, nevojën për këtë rregullore, rëndësinë e saj, si dhe me qëllim të rritjes së efektivitetit të normimit dhe në favor të lehtësimit të zbatimit të saj në praktikë, dhe duke marrë për bazë aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese, Komisionit ia paraqet për shqyrtim dhe procedim të mëtejshëm. Pa dyshim që është një version i avancuar i rregullores ku kemi harmonizuar me dispozita kushtetuese dhe aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe po ashtu ky draft avancon aspektin legjislativ dhe mbikëqyrës të Kuvendit, si dhe rolin e Kuvendit në çështjen e integritetit evropian.

Në takimin e fundit ka mbetur që grupi 6+ me e sjell me shkrim një propozim lidhur me nenin 12 ku flitet për Zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, deri tani nuk e kanë sjellë, por kjo nuk ju ndalon që ata ta bëjnë amendament në mes të dy leximeve.

Në tri takimet e fundit të grupit punues jemi ftuar në përbërje të plotë për të marrë pjesë në punëtori ku disa anëtarë edhe të grupit punues, por edhe të komisionit nuk kanë qenë prezent gjatë gjithë kohës dhe kjo ka bërë që të shpëputet konsistenca shpeshherë edhe në propozime. Gjatë gjithë kohës prezent kanë qenë deputetët Bilall Sherifi, Sami Kurteshi, Bahrim Shabani, Shkumbin Demaliaj dhe unë që kam kryesuar këtë grup. Grupi parlamentar i LDK-së ka pasur shpëputje kohë pas kohe dhe kanë marrë pjesë deputete një pjesë të takimeve Korab Sejdiu në pjesën tjetër Arben Gashi, si dhe deputeti Driton Selmanaj, ndonëse nuk është anëtar i Komisionit për Legjislacion.

Janë dy-tri dilema që sot duhet t'i heqim dhe ta procedojmë Rregulloren për lexim të parë. E para ishte një propozim i deputetit Arben Gashi që në nenin 66 ku flitet për leximin e parë Komisionin përgjegjës raportues për Projektligje ta ngarkojë Kryesia e Kuvendit, kurse propozim i grupit ka qenë të mbetet Kryetari i Kuvendit për shkak edhe të praktikës së krijuar dhe të efikasitetit. Ky ndryshim nuk është reflektuar edhe në nenet e tjera pasi në pjesën tjetër të ditës nuk ishte prezent z. Gashi. P.sh. nenet 76,77,81,100 etj., ku do të duhej të përcillej logjika e njëjtë.

Z. Beqa kërkoi që të përkrahet propozimi i grupit punues ose të bëhen ndryshime edhe në këto nene që përmendi. Në fund, në nenin 119, ku flitet për Çështjet e mbetura në procedurën e

shqyrtimit, janë dy propozime, një propozim është të mbetet versioni siç ka qenë dhe një propozim e ka z. Sami Kurteshi.

Konsideroj që nuk duhet të humbim shumë kohë dhe kërkoj mirëkuptimin e z. Kurteshi që nëse edhe më tej konsideron që duhet të mbetet propozimi i tij ta bëjë si amendament personal, por që të mos shkojmë në këtë variant. Ju lus që sot të mos hyjmë në debat, sepse debatin e kemi shter në grupe punuese dhe kemi përafruar qëndrimet, secili grup parlamentar jemi tërheq në disa pika që s'jemi pajtuar, por që kemi arritur me e ndërtuar një konsensus të përbashkët dhe kemi ardhur në këtë pikë ku kërkohet deklarimi i Komisionit për procedim të mëtejshëm.

Sami Kurteshi tha se ne kemi punuar në grupin punues, natyrisht me rezerva të ndryshme. Mendoj se është diskutuar gjatë ku jemi marrë vesh që të dërgohet teksti kështu dhe Grupi Parlamentar i Vetëvendosjes do të propozojë amendamente pas leximit të parë.

Bilall Sherifi tha se të gjitha ndryshimit që janë bërë janë të mira dhe të dobishme për të përmirësuar punën e Kuvendit, por megjithatë kemi mbetur tek disa çështje që janë shumë të rëndësishme, që do të bënin reformën e vërtetë të Rregullores së Punës të Kuvendit duke pohuar se nëse në këto çështje nuk gjejmë konsensus atëherë kemi mbetur vetëm në ndryshime kozmetike në Rregullores.

Kryetarja tha se vërejtja ime është te neni 21 i Rregullores ku flitet për Konferencën e Kryetarëve janë futur edhe nënkryetarët e Kuvendit me propozim të z. Gashi, për të cilën duhet të pasur parasysh se Konferenca e Kryetarëve është një mekanizëm që duhet të përbëhet vetëm nga Kryetari i Kuvendit dhe kryetarët e Grupeve Parlamentare që përfaqësojnë vullnetit politik në Kuvend. Znj. Haxhiu u dakordua që te neni 66, në vend të 'kryesisë së Kuvendit' të bëhet 'kryetari i Kuvendit' duke pasur parasysh që në Kuvend vijnë shumë projektligje dhe është e pamundur që të mbledhësh kryesinë që të ngarkojë Komisionet Parlamentare për Projektligjet përkatëse. Ndërsa te neni 119, ku flitet që të vazhdohet në legjislaturën e ardhshme te punët që ka mbetur propozim i z. Sami Kurteshi tha se nuk mbështes për arsye se secila Qeveri që vjen ka politikën e veta në të gjitha fushat përveç çështjeve të peticioneve për të cilën jam që të vazhdohet aty ku ka mbetur.

Bahrim Shabani tha se grupi punues ka bërë një punë të mirë dhe janë bërë disa ndryshime të cilat janë të dobishme për mbarëvajtjen e punës së Kuvendit. Kam propozuar që neni 12, ku flitet për zgjedhjen e nënkryetarëve të Kuvendit, sepse ne kemi problem rreth zgjedhjes së nënkryetarit nga radhët e komuniteteve të tjera dhe propozimi është që ai deputet që i ka 6 nënshkrime prej këtyre 10 deputetëve të propozohet për nënkryetar të Kuvendit nga radhët e komuniteteve të tjera dhe ky nënkryetar të jetë nga fillimi i mandatit deri në fund të mandatit në mënyrë që mos të bëhet me rrotacion.

Kryetarja tha se e kuptoj shqetësimin e z. Shabani dhe kemi diskutuar në grup punues në lidhje me këtë, por mendoj se zgjedhja duhet të jetë e njëjtë si te shqiptarët dhe te komunitetet e tjera.

Sami Kurteshi tha se kam pasur propozim edhe për marrëveshjet ndërkombëtare që kërkon ratifikimin në Kuvend përpara se të nënshkruhet një marrëveshje së pari të vijë në Kuvend për diskutim dhe miratim dhe më pas të nënshkruhet.

Hajdar Beqa tha se në parim jemi pajtuar të gjithë me propozimin e z. Kurteshi, por e kemi parë që ky propozim nuk e ka vendin në Rregullore, por duhet që kjo çështje të rregullohet me ligj. Po ashtu dua të theksoj se sa i përket z. Shabani ne, në grup punues, kemi diskutuar mjaft, por është Kushtetuta që na kufizon në lidhje me këtë çështje.

Sami Kurteshi tha se sa i përket nenit 119 dhe 120 të Rregullores, për çështje parimore nuk tërhiqem sepse Institucionet tona duhet ta ketë një memorie. Qeveria e re vjen, por nuk krijohet shtet i ri sepse është bërë një punë paraprake. Ndërsa te marrëveshjet ndërkombëtare në nenin 75, paragrafi 6 thotë se teksti i marrëveshjes nuk amendamentohet sepse është normë e drejtës ndërkombëtare, por shqetësimi im është se teksti marrëveshjes të diskutohet para nënshkrimit sepse ti po e kufizon Kuvendin me të drejtë procedurale që posedon.

Tek neni 66, ku flitet për Shqyrtimin e parë të Projektligjit, paragrafi 2 propozohet që 'Kryetari Kuvendit të ngarkojë komisionin raportues për Projektligje. Sami Kurteshi dhe Korab Sejdiu abstenuan.

Neni 119, ku flitet për çështjet e mbetura në Procedurë propozim i Sami Kurteshit mori 3 vota për 3 kundër dhe 2 abstenime, i cili nuk kalon dhe mbetet versioni aktual i Rregullores.

Neni 75 i Rregullores, ku flitet Ratifikimin e Marrëveshjeve Ndërkombëtare, z. Kurteshi ka propozuar një paragraf të ri me të cilën komisioni vendosi që të përkrahë këtë propozim me vota 5 për dhe 3 kundër. 'Marrëveshjet Ndërkombëtare para nënshkrimit të diskutohen në Kuvend'.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni procedon me projekt-rregulloren e Kuvendit, e cila sipas Rregullores, ju shpërndahet deputetëve para miratimit në parim.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale

Kryetarja paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe i ftoi anëtarët që të deklarohen në lidhje me këtë projektligj.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se komisioni, një zëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

Rekomandim

- 1.** Projektligji nr. 06/L-015 mbi masat doganore për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.

2. Projektligji me amendamente e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i propozim vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës me kandidatët për anëtar të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Kryetarja paraqiti për shqyrtim propozim vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës me kandidatët për anëtar të Komisionit për Dhënien e Provimit të Jurisprudencës dhe tha se 3 anëtarë prof. dr. Haxhi Gashi, anëtarë i komisionit, pyetës i lëndës e drejta civile (materiale dhe procedurale), Albert Zogaj dhe Gazmend Nushi, zëvendësanëtarë nuk i plotësojnë kriteret e parapara sipas nenit 4, paragrafi 3 i Ligjit nr. 04/L-141 për Provimin e Jurisprudencës për të qenë pjesë e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës në të cilën kërkohet 12 vjet përvojë pune në sistemin e drejtësisë. Po ashtu vërejtje e imja është se z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokurori i Shtetit, është propozuar kryetar i këtij komisioni dhe duke qenë se është Kryeprokuror i Shtetit ai njëherësh është shumë i ngarkuar me punë dhe ne po e ngarkojmë edhe me një punë shtesë atë të Kryetarit të Komisionit për Provim të Jurisprudencës. Unë besoj se Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryetarja së Gjykatës Themelore të cilët janë të stërngarkuar me punë, ne po i japim edhe punë tjetër shtesë duke i bërë edhe anëtarë të Komisionit për provim të Jurisprudencës. Kryetarja ftoi nga anëtarët të deklarohen për vërejtjet e tyre.

Shkumbin Demaliaj tha se e rëndësishme është që për të dhënë provimin e jurisprudencës janë duke pritur shumë juristë që të futen në këtë provim dhe i përkrah këto propozime përveç aty ku shkelet ligji.

Hajdar Beqa tha se sa më shpejt të jetë e mundur ky komision duhet të fillojë punën sepse janë shumë studentë, juristë të cilët janë duke pritur për të dhënë këtë provim Jurisprudencës. Më tej z. Beqa tha se nuk është shumë e rëndësishme se a po ngarkohet me punë Kryeprokurori, sepse ai ka agjendën e vet dhe praktikë është që dikush nga sistemi i Drejtësisë të jetë në këtë Komision. Ndërsa sa i për tre kandidatëve që nuk i plotësojnë 12 vjet përvojë pune në sistemin e Drejtësisë, propozoj që të formohet një grup punues që t'i verifikojë edhe një herë se a i plotësojnë kushtet ashtu si është e shkruar në ligj duke marrë edhe mendime juridike, sepse z. Haxhi Gashi është Dekan në Fakultetin e Drejtësisë.

Kryetarja tha se shqetësim i imi është të mos shkelet ligji duke e cituar nenin 4, paragrafin 3 të Ligjit për Provim të Jurisprudencës.

Korab Sejdiu tha se këta persona kanë përvojë në sistemin drejtësisë sipas ligjit, por a është lista më e mirë e mundshme, kjo sigurisht që mund të diskutohet dhe jam i vetëdijshëm që do kishte lista edhe më të mira. Ka shumë juristë të rinj që më kontaktojnë, të cilët presin të japin provimin e jurisprudencës dhe ne e kemi për detyrë që mos të bëjmë vonesa nëse nuk ka shkelje evidente të

ligjit, gjë që personalisht nuk po shoh që ka shkelje të ligjit. Nuk pajtohem me kryetaren, që Fakulteti Juridik nuk cilësohet si përvojë e institucioneve të drejtësisë, sepse aty përgatiten juristë dhe numërohet si përvojë Juridike përfshirë edhe Gjykatën Kushtetuese. Pra, nuk e shoh si pengesë sepse do të përjashtonte një numër goxha të njerëzve nga shërbimi dhe jam për që këto propozime të procedohen për seancë plenare.

Kryetarja, theksoi se kapitulli 7 i Kushtetutës e specifikon qartë se kush është sistemi i Drejtësisë, por jo Universiteti i Prishtinës. Fajin nuk e ka Komisioni për Legjislacion, por Ministria e Drejtësisë që për muaj të tërë ka neglizhuar vendimin për formimin e Komisionit për dhënien Provimit të Jurisprudencës. Po ashtu theksoi se nuk është respektuar as marrëveshja me Ambasadën Britanike në Madhe në lidhje dhe nuk janë konsultuar ekspertët e kësaj ambasade në lidhje me këto propozime. Propozimi im është që mos të aprovohet propozimi i Qeverisë.

Nezir Çoçaj tha se kemi pasur edhe një rast të tillë edhe në komisionin e kaluar dhe jam që të shqyrtohen këto propozime në mënyrë që të mos bëjmë shkelje të ligjit edhe pse për mendimin tim profesorët e fakultetit janë më kompetentët për Komisionin e Dhënies së Provimit të Jurisprudencës.

Arben Gashi tha se shqetësimet që i kemi ne mund të kërkojmë informacione shtesë, përndryshe nuk kemi zgjidhje tjetër përveç se të rekomandojmë për miratim ose mosmiratim të vendimit të propozimeve të Qeverisë në seancë plenare. Koncepti modern i sistemit të drejtësisë mendoj se është shumë i gjerë, ndaj nuk jam për interpretim të ashpër, por për interpretim liberal.

*Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni, me shumicë votash **8 vota për dhe 1 kundër**, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

R e k o m a n d i m

- I. *Të miratohet propozim-vendimi i Ministrisë së Drejtësisë, për formimin e komisionit për dhënien e provimit të jurisprudencës, me anëtarët dhe zëvendësit e tyre si vijon:*
 1. Aleksandër Lumezi, kryetar i komisionit, pyetës për lëndën: E drejta penale, dhe zëvendësanëtar i komisionit z. Besim Kelmendi;
 2. Prof. dr. Haxhi Gashi, anëtar i komisionit pyetës për lëndën: E drejta civile (materiale dhe procedurale), zëvendësanëtar i komisionit Albert Zogaj;
 3. Prof. dr. Nebojsa Boriqiq, anëtar i komisionit, pyetës i lëndës: E drejta tregtare, zëvendësanëtar i komisionit Gazmend Nushi;
 4. Afërdita Bytyçi, anëtare e komisionit, pyetëse e lëndës: E drejta kushtetuese, organizimi i sistemit gjyqësor të Kosovës, bazat e sistemit të Bashkimit Evropian dhe të drejtat e njeriut dhe zëvendësanëtar Qerim Fazliji;

5. Enver Peci, anëtar i komisionit, pyetës i lëndës: E drejta e punës dhe E drejta administrative, zëvendësanëtare e komisionit Emine Kaçiku.

5. Të ndryshme

Arben Gashi tha se nuk mund të jetë kryesues i Grupit Punues për Ndërmjetësim për arsye se kam disa obligime të tjera në këtë periudhë kohore dhe propozoj që kryesimin ta marrë dikush tjetër nga anëtarët e komisionit.

Në vend të z. Arben Gashi për kryesim të Grupit Punues për Ndërmjetësim u propozua z. Nezir Çoçaj.

Mbledhja përfundoi në orën 13:15.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu